

NJOFTIM

Klientët e lidhur **në nivelin e tensionit 6 kV**, të cilët sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", u përfundon afati i furnizimit nga FMF (FSHU sh.a.), nga data **1 janar 2026**, kanë të drejtë të furnizohen nëpërmjet furnizuesve të licencuar që ofrojnë këtë shërbim. Në faqen e ERE-s www.ere.gov.al, në platformën e krahasimit të çmimeve **PCT** (Price Comparison Tool), që gjendet në faqen e ERE <https://pct.ere.gov.al/>, mund të kërkonti dhe gjeni ofertat e furnizimit me energji elektrike.

Nëse nuk keni mundur të kontraktoni vetë një furnizues ose keni humbur furnizuesin tuaj, mund të përfitoni edhe nga furnizimi për një periudhë të kufizuar kohe (**60 ditë**) nga "Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" i cili aktualisht ushtrohet nga FSHU sh.a.

Në çdo kohë keni të drejtë për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, **si një e drejtë e garantuar me ligj**.